



Pranuar / Doretur / Prijmljeno / Predato Received / Delivered	01.09.2022	2	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojc e Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHCK	5071/2022		114



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr. 595/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës –Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi–Bajraktari dhe Jeton Kocanëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr. 595/2022, të datës 05.07.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi rruga banesat nga Komuna e Prizrenit, kundër organit të punësimit Kuvendi i Kosovës, në çështjen juridike “kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 01.09.2022 mori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET si e bazuar ankesa A.nr. 595/2022, të datës 05.07.2022 të parashtruar nga ankuesi
- II. OBLIGOHET Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Republikës së Kosovës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij, që ankuesit ti bëjë kompensimin e shpenzimeve (mëditjeve) për ankuesin lidhur udhëtimin zyrtar të realizuar me nga data 16.05.2022, deri me datën 19.05.2022, në Zvicër.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës sipas Akt Emërimit DÇLP-01/11-16 në pozitën Zyrtar Ligjor për Mbështetje Kryesisë së Kuvendit dhe Seancës Plenare, nga data 16-19.05.2022 ka marr pjesë vizitën studimore në Zvicër, mirëpo të njëjtit nuk i janë paguar shpenzimet e mëditjeve të ushtrimit jashtë vendit.

Ankuesi me datë 05.07.2022, me numër protokoli 3915/2022, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, të Kosovës me pretendimet ankimore lidhur me kompensimin e shpenzimeve respektivisht mëditjeve për udhëtimin zyrtar të realizuar me nga data 16.05.2022, deri me datën 19.05.2022, në Zvicër.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, më datë 19.07.2022, me numër protokoli 4192/2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Kuvendi i Republikës së Kosovës, ndërsa me datë 27.07.2022 me numër protokoli 4367/2022, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Kuvendi i Kosovës, me shkresat e bashkangjitura.

Për shkak të specifikave të lëndës, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datës 18.08.2022 ka nxjerr Vendim VK.nr.81/2022 me të cilin ka bërë zgjatjen e afatit për vendosjen e ankesës së ankuesit për dhjetë (10) ditë pune.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën A.nr. 595/2022 e datës 05.07.2022, me numër protokoli 3915/2022, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vërtetim i datës 04.07.2022; e-maili i datës 08.03.2022; vendim i datës 02.07.2018; e-maili i datës 13.07.2022; e-maili i datës 14.07.2022; e-maili i datës 21.07.2022; e-maili i datës 27.07.2022; Notë verbale e datës 27.03.2022; e-maili i datës 28.03.2022; e-maili i datës 29.03.2022; e-maili i datës 12.05.2022; e-maili i datës 15.05.2022; dëshmi pasaporta e ankuesit; Procesverbali i datës 15.11.2018; Akt Emërimi i datës 19.06.2017; e-maili i datës 29.12.2021; e-maili i datës 16.05.2022; Evidenca mujore e muajt maj të vitit 2022; e-maili i datës 29.09.2021; Vendimi i datës 13.06.2022; kërkesë për lejimin e udhëtimit zyrtar e datës 21.04.2022; ftesa e datës 21.03.2022; kërkesë për udhëtim zyrtar për \_\_\_\_\_ kërkesë për udhëtim zyrtar për \_\_\_\_\_ kërkesë për udhëtim zyrtar për \_\_\_\_\_ kërkesë për udhëtim zyrtar për \_\_\_\_\_ kërkesë për udhëtim zyrtar për \_\_\_\_\_ kërkesë për udhëtim zyrtar për \_\_\_\_\_ kërkesë për udhëtim zyrtar për \_\_\_\_\_ Përgjigjeje në ankesë e datës 27.07.2022, me numër protokoli 4367/2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit \_\_\_\_\_ është e bazuar,  
**SEPSE:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon që nuk i janë dhënë mëditjet e udhëtimit zyrtar siç parashihet me Udhëzimin Administrativ Nr. MSHP 2004/07 për Udhëtimet Zyrtare respektivisht me vendimin me Nr. 30/2018 të datës 19.06.2018 të Ministrisë së Financave.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke i'u referuar dispozitave ligjore në fuqi për rastin konkret, konstaton se Ligji Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, konkretisht neni 20 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1, përcakton se: "Nëpunësit civilë kanë të drejtë në kompensimin e shpenzimeve të kryera gjatë ushtrimit të detyrës, si vijon: 2.1. shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit gjatë një udhëtimi apo vizite zyrtare brenda ose jashtë Kosovës", po ashtu këtë e përcakton edhe neni 15 i Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë,

rrjedhimisht në bazë të shkesave të lëndës, shihet qartë që kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Zvicër prej datës 16-19.05.2022 është përgatitur më datë 21.04.2022 dhe e njëjta është drejtuar për Sekretarin e Përgjithshëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës nga ankuesi, mirëpo nuk ka dëshmi që e njëjta të jetë aprovuar nga Drejtoria e Personelit, bazuar në këtë kërkesa është përgatitur konform nenit 3 të Udhëzimit Administrativ Nr. MSHP 2004/07 për Udhëtimet Zyrtare.

Bazuar në shkresat e lëndës, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Republikës së Kosovës përmes emailit të datës 16.05.2022 ka njoftuar Drejtoreshën e Drejtorisë së Personelit që vendimet e përmendura janë firmosur me një urgjencë nga ZKA, sa i përket procedurave për aplikim për viza, kjo nuk do të thotë se nuk duhet të respektohet praktika e deritanishme, ndërsa Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Republikës së Kosovës përmes emailit të datës 28.06.2022 të dërguar për ka kërkuar që të zbatohen vendimet duke kërkuar që nënshkruhen formularët e realizimit dhe kompensimeve të mëditjeve për udhëtime zyrtar të stafit, pasi të njëjtat nuk po nënshkruhen nga zyrtarja vartëse e juaja.

Udhëzimi Administrativ Nr. MSHP 2004/07 për Udhëtime Zyrtare, konkretisht neni 11, përcakton se: **“Pagesa për ditët e udhëtimit zyrtar fillon në ditën e nisjes dhe përfundon në ditën e kthimit. Dita e nisjes dhe dita e kthimit llogariten si ditë e udhëtimit zyrtar pa marrë parasysh kohën e nisjes apo të arritjes”**, ndërsa shuma e tarifave paguhet sipas tarifave të përcaktuara nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave sipas nenit 12 të këtij udhëzimi, ndërsa lidhur me këtë Ministria e Financave më datë 19.06.2018 ka nxjerr Vendim me Nr. 30/2018 me të cilin të cilin janë aprovuar tarifat e rishikuara për udhëtimet jashtë vendit.

Nga të lartcekura, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Kuvendi i Kosovës, është e obliguar që të ndër marrë veprimet juridike në pajtim me Udhëzimin Administrativ Nr. MSHP 2004/07 për Udhëtime Zyrtare dhe Vendimin me Nr. 30/2018 të datës 19.06.2018 të Ministrisë së Financave, të bëjë kompensimeve e mëditjeve të udhëtimit zyrtar jashtë vendit për ankuesin për ditët nga data 16-19.05.2022.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.


Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
**Lënda me numër A. nr. 595/2022**

Çlirim ZEKA

  
Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Kuvendin e Republikës së Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK-së,

